




Nr. 69 prot  
Dt. 12/12/2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 4 Datë 11.12.2018

**“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË UJRAVE TERMALE ” SUBJEKTIT  
“NESIMI- Construction-78” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51 dhe nenit 52, të ligjit nr. 6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 dt.15.11.2012 Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM nr.416 datë 13.05.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozim të A.B.U. Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin e lejes për përdorim të ujrave termale, **Përroit të Banjave**, për qëllime kurative, në fshatin Begjunec, Njësia Administrative Melan, Bashkia Dibër, Qarku Dibër, subjektit **“NESIMI- Construction-78” sh.p.k.** me administrator Z. Zyber NESIMI.

|  |   |                  |              |
|--|---|------------------|--------------|
| Koordinatat e veprës së marrjes :                  | X - 53 78 21.8;   | Y - 46 16 779.2; | Z - + 602 m; |
| Koordinatat e pikes së shkarkimit :                | X - 53 76 89.1;   | Y - 46 16 726.7; | Z - + 591 m; |
| Prurja mesatare vjetore :                          | Q mes/vjetore = 0.0085 m <sup>3</sup> /sek = 8.5 l/sek; |                  |              |
| Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: | Q llog = 0.00601 m <sup>3</sup> /sek = 6.01 l/sek;      |                  |              |
| Prurja ekologjike:                                 | Q ekol = 0.0024 m <sup>3</sup> /sek;                    |                  |              |
| Prurja që shkarkohet:                              | Q = 0.00601 m <sup>3</sup> /sek = 6.01 l/sek;           |                  |              |

2- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR  
Raimonda GURI



KRYETAR  
Çesk MILLJA

